



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0856

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga; Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FORTESA” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Gjakovës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit 632-23-5381-5-2-1, me 26/01/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit ekonomik “FORTESA” SH.P.K., me nr. 2023/0856, e datës 31/10/2023, kundër, vendimit të Autoritetit kontraktues “Komuna e Gjakovës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit: 632-23-5381-5-2-1.
2. Anulohet “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 20.10.2023, i Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: 632-23-5381-5-2-1. dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE “FORTESA” SH.P.K, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 31.05.2023, “Komuna e Gjakovës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale”. Ndërsa me datën 20.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 300,000.00 €.

Me 24.10.2023, OE “FORTESA” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 26.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 31/10/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “FORTESA” SH.P.K., me nr. 856/23 lidhur me aktivitetin “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit 632-23-5381-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FORTESA” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

OE sqaron “Me datën 01 Qershor 2023, AK – KOMUNA E GJAKOVËS përmes platformës publike eprokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me nr. prokurimi: 632-23-5381-5-2-1. Operatori Ekonomik “FORTESA SHPK” ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me OE ALBAPROJECT SHPK & N.P. Auremont duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Autoriteti Kontraktues me datën 07.08.2023 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK të vlerësimit fillestar, tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë GOE BERISHA COM SH.P.K. & JOOS & KRASNIQI – BAZË SH.P.K. dhe ofertën tonë e vlerëson si tenderues të pasuksesshëm duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së. Pas marrjes së Vendimit të Autoritetit Kontraktues për vlerësimin fillestar ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim e cila është aprovuar nga ana e AK-së dhe lënda është kthyer në rivlerësim. Pas kësaj AK me dt. 06.10.2023 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK për rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM dhe ofertën tonë e vlerëson si tenderues të pasuksesshëm njëjtë duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së. Pas marrjes së Vendimit të Autoritetit Kontraktues për ri-vlerësimin ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim e cila gjithashtu është aprovuar nga ana e AK-së dhe lënda prapë është kthyer në rivlerësim. Pas kësaj AK me dt. 20.10.2023 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK për rivlerësimin e dytë të këtij aktiviteti të prokurimit tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë prapë GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 22.10.2023 ku pastaj qasja është mundësuar me dt. 23.10.2023. Tek ky vendim i AK-së nuk është marrë parasysh asnjë nga pretendimet tona dhe AK ka vazhduar me shkeljet e njëjta. Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit. Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t’i parashtrojmë në këtë “Ankesë” kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me

LPP-në duke bërë Shkelje të rënda të cilat parashihen me nenin 97 të RRPP-së si dhe duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet e vlerësimit të prokurimit. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore”

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon: “AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.f i RRPP-së) pasi nuk ka zbatuar nenin 30.4 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022: Neni 30 Validiteti i Tenderit 30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkojë para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit) Hapja e ofertave është bërë me dt. 03.07.2023 si dhe periudha e vlefshmërisë së tenderëve ka qenë 60 ditë sipas FTD-së. Andaj të gjitha ofertat kanë qenë valide deri me dt. 01.09.2023 (Kalkulimin e afatit prej 60 ditësh do e bashkëngjisim në këtë ankesë). Duke parë se AK nuk po respekton dispozitat ligjore të Prokurimit Publik në mënyrë vullnetare kemi ngarkuar në sistem me dt. 31.08.2023 ora 12:45 konfirmimin për vazhdim të validitetit të ofertës sonë edhe për 60 ditë tjera si dhe e kemi informuar AK-në se është duke bërë shkelje të nenit 30.4 të RRPP-së (Konfirmimin për vazhdim të validitetit të ofertës sonë do e bashkëngjisim në këtë ankesë). AK në kundërshtim me nenin 30.4 të RRPP-së kërkesën për vazhdim të validitetit e ka publikuar me vonesë me dt. 04.09.2023. Pasi kemi pranuar dokumentet e ofertuesve tjerë në këtë aktivitet të prokurimit pas qasjes në dokumente zyrtare të dt. 06.10.2023 rezultoi se asnjë nga OE tjerë nuk e ka vazhduar validitetin e ofertave sipas dispozitave ligjore për Prokurim Publik pasi validiteti i ofertave nuk duhet të ketë shkëputje por të ketë vazhdimësi/kontinuitet. Andaj sipas të gjitha këtyre fakteve të paraqitura rezultoi se jemi ofertuesi i vetëm si “palë me interes” që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së. Në lidhje me këtë çështje kemi edhe shumë raste të gjykuara si nga ekspertët shqyrtues poashtu edhe nga paneli shqyrtues siç janë vendimet e OSHP-së nr. 670/20, 728/20, 962/20, 1151/20, 194/22, 94/23, etj. Po ashtu lidhur me këtë kemi edhe një interpretim nga KRPP në ueb faqen zyrtare më saktësisht Pyetja nr.7 (Interpretimin do e bashkëngjisim në këtë ankesë). Pra edhe pse vetëm ky pretendim është i mjaftueshëm që të gjithë OE tjerë duke përfshirë edhe OE të rekomanduar për kontratë të shpallen të papërgjegjshëm si dhe “palë pa interes” ne do të paraqesim edhe pretendimet tjera për shkeljet tjera që janë bërë nga AK me rastin e rivlerësimit. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi provon të arsyetojë këtë shkelje duke pretenduar se vlefshmëria e ofertave ka qenë dy muaj e në fakt sipas FTD-së është 60 ditë, pra nuk është e njëjte periudha prej dy muajsh me periudhën 60 ditë.”

Pretendimi i dytë (II) ankuesi pretendon: “Të njëjtën shkelje të nenit 30.4 të dhe nenit 97.f të RRPP-së AK e ka bërë edhe me rastin e kërkesës për vazhdimin e sigurimit të ofertave. Të gjitha ofertat, sipas kërkesës në FTD, periudhën e sigurimit të ofertës e kanë deri me datën 01.10.2023, ndërsa AK me dt. 02.10.2023 ka publikuar në sistem kërkesën për vazhdimin e tyre. Duke parë se AK nuk po respekton dispozitat ligjore të Prokurimit Publik, në mënyrë vullnetare ne kemi ngarkuar në sistem me dt. 29.09.2023 ora 14:19 vazhdimin e sigurimit të ofertës edhe për 90 ditë tjera nga data e skadimit 01.10.2023 (Vazhdimin e sigurimit të ofertës do e bashkëngjisim në këtë ankesë). Pasi kemi pranuar dokumentet e ofertuesve tjerë në këtë aktivitet të prokurimit pas qasjes në dokumente zyrtare të dt. 06.10.2023 rezultoi se asnjë nga OE tjerë nuk e ka vazhduar sigurimin e ofertave sipas dispozitave ligjore për Prokurim Publik. Andaj edhe sipas këtij pretendimi rezultoi se jemi ofertuesi i vetëm si “palë me interes” që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi provon të arsyetojë këtë shkelje duke pretenduar se Operatorët Ekonomik kanë dorëzuar vazhdimin e sigurimit menjëherë me dt. 02.10.2023 mirëpo kjo nënkupton se kërkesa për vazhdim të sigurimit të ofertave po ashtu edhe vazhdimi është bërë pas skadimit të vlefshmërisë së tyre.”

Pretendimi i tretë (III) ankuesi pretendon: “ AK ka bërë shkelje të nenit 10.3 të LPP-së pasi pas qasjes në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga GOE EuroVia SH.P.K. & ISEFERI SH.P.K. të dt. 14.08.2023 rezulton se AK i ka siguruar qasje këtij GOE në dokumentet e ofertës sonë të cilat dokumente ne i kemi klasifikuar si sekret afarist gjithnjë sipas nenit 11.3 të LPP-së. Neni 39.3 (ii) i Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 e paraqet shumë qartë këtë çështje: (ii) Të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-se në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit. Pra me këtë AK gjithashtu ka bërë shkelje të nenit 11 dhe nenit 55.3 të LPP-së si dhe nenit 7, nenit 39.3 (ii) dhe nenit 47.11 të RRPP-së. Kjo shkelje gjithashtu cilësohet edhe si neglizhim i qasjes në dokumente zyrtare dhe klasifikohet si Shkelje e rëndë gjithnjë sipas nenit 97.c të RRPP-së. AK gjithashtu ka vazhduar me shkelje tjera të dispozitave ligjore të LPP-së me rastin e rekomandimit për shpërblim me kontratë të GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM pasi i njëjti edhe pse sipas pretendimit nr. 1 dhe 2 nuk paraqet palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit gjithashtu nuk përmbush edhe kriteret tjera të vendosura në FTD të cilat do i paraqesim në pretendimet në vijim. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi provon të arsyetoj këtë shkelje duke pretenduar se qasja është bërë konform Ligjit për Qasje në Dokumente Publike e cila nuk qëndron pasi ne këto dokumente i kemi cilësuar si sekret afarist gjithnjë sipas nenit 11 të LPP-së.”

Pretendimi i katërt (IV) ankuesi pretendon: “Pas analizimit të hollësishëm të dokumentacionit të siguruar nga qasja zyrtare në dosjen e tenderit të GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM, duke analizuar edhe çmimet dhe kushtet e tregut kemi vërejtur se oferta financiare (paralogaria) në shumicën e elementeve/pozicioneve është me çmime të cilat në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut andaj në pikëpamje faktike fillimisht përbën tender jo të besueshëm dhe me çmime manipulative i cili ka për qëllim të shtrembërojë konkurrencën e drejtë të OE ankues dhe tenderuesve pjesëmarrës, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me çmimet dhe kushtet e tregut dhe konkurrencës. Ndërsa në pikëpamje juridike bazuar në kërkesat ligjore nga neni 61 i LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik, i njëjti përbën tender me çmime jo-normalisht të ulët dhe njëkohësisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Andaj si i tillë në kuptim faktik e juridik ky tender do të duhej që të refuzohej si tender jo-normalisht i ulët, rrjedhimisht tender i papërgjegjshëm. Provë: Të bashkangjitura janë ofertat e këtyre kompanive dhe e-mali i komunikimit. Në lidhje me këtë pozicion ne do të paraqesim edhe një analizë çmimi duke marrë parasysh sasi të materialeve që nevojiten për prodhimin e këtyre gypave. Në këtë analizë nuk janë përfshirë edhe kokat hyrëse dhe dalëse të cilat e rrisin koston edhe më shumë. (Analizën e çmimit për prodhimin e këtyre gypave do e bashkëngjisim në këtë ankesë). Andaj kjo ofertë e cila ka dallim substancial me çmimet reale të tregut rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës dhe kufizon / shtrembëron konkurrencën e lirë të OE ankues në raport me ofrimet të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat dhe çmimet reale të tregut. Prandaj AK do duhej ta trajtoj si tender jo normalisht të ulët dhe të njoftoj KRPP brenda dy dite sipas nenit 41.10 pika b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët”. Pra AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë këtë GOE pa realizuar asnjë hulumtim të tregut për këto pozicione duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi thekson se përgjigjet e këtij GOE janë konsideruar si bindëse nga komisioni i vlerësimit përkundër shkeljeve që i kemi paraqitur më lartë.”

Pretendimi i pestë (V) ankuesi pretendon: “GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM nuk plotëson kërkesën e përcaktuar tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: b).Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik apo Master drejtimi hidroteknik me 5 vite përvojë pune pas diplomimit pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar: Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohej me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani. Në lidhje me këtë kërkesë ky GOE ka ofruar dëshmitë e

inxhinierit Astrit Salihu ku ka pretenduar se ky person është i angazhuar me kontratë të rregullt në kompaninë N.N.SH. “WORLD MEDIUM” dhe ka paraqitur një kontratë pune të rregullt të datës 23.04.2021 po ashtu e noterizuar në të njëjtën datë. Mirëpo kjo kontratë shihet se nuk ka qenë efektive asnjëherë pasi ky OE ka paraqitur gjithashtu listën e pagave nga ATK për vitin 2022 dhe nuk figuron ky person në këtë listë. Andaj kjo kontratë mund të jetë e shkëputur nga njëra palë dhe nuk është efektive pasi edhe tek neni 19 i kësaj kontrate ceket se: Punëdhënësi obligohet t’i paguaj kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të përcaktuara me Ligj. Pra, ky inxhinier nuk është i angazhuar si staf i rregullt në këtë kompani andaj mungon kontrata mbi vepër duke specifikuar titullin e projektit ashtu siç është e përshkruar kërkesa në FTD. Pra, AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 69 të LPP-së. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi thekson se ky GOE ka ofruar dëshmitë siç është kërkuar në FTD, mirëpo dyshimet e paraqitura nga ana jonë nuk janë marrë parasysh nga ana e AK-së duke mos kërkuar asnjë sqarim shtesë nga ky GOE.”

Pretendimi i gjashtë (VI) ankuesi pretendon: “GOE Quality Asphalt SH.P.K. & CAPITAL X FET SH.P.K. & N.N.SH. WORLD MEDIUM nuk plotëson kërkesën e përcaktuar tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dëshmia e kërkuar: Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim. Pasi ky GOE ka ofruar pajisjen Eskavatorr Liebherr A904 HDSL në pronësi të kompanisë NNSH WORLD MEDIUM e cila pajisje nuk është sipas kërkesës pasi nuk është ekskavator me goma mirëpo është me zinxhir sipas të gjitha katalogëve. Pra kjo pajisje nuk përmbush këtë kërkesë. Prandaj AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 69 të LPP-së. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi provon të arsyetoj këtë shkelje duke pretenduar se GOE ka prezantuar faturën për pajisjen në fjalë. Fatura e bashkangjitur në Vendimin e AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim ka të bëjë me një ekskavator tjetër i cili nuk gjendet tek lista e paraqitur në Aneksin nr.7 të këtij GOE. Mirëpo edhe nëse kjo merret si e mirëqenë prapë AK ka prezantuar një Eskavator Liebherr A902 i cili sipas të gjitha katalogëve nuk e kalon peshën prej 17 ton. Pra edhe pse makineria e paraqitur nga GOE është ndryshuar nga ana e AK prapë e njejta nuk përmbush kriterin e përcaktuar tek lista e pajisjeve në FTD. Pretendimi i shtatë AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së pasi ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një GOE i cili nuk ka dëshmuar që përmbush të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë pasi nuk ka dorëzuar 3. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; Pra ky vërtetim nuk është dorëzuar nga ky GOE edhe pse ka qenë kërkesë e specifikuar në FTD. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi thekson se GOE i rekomanduar për shpërblim me kontratë ka prezantuar vërtetimet e gjykatës dhe ATK-së për 3 anëtarët e grupit siç është kërkuar në FTD e cila nuk qëndron pasi vërtetimet e gjykatës për drejtuesit e këtyre kompanive (sipas kërkesës së pikës a) nuk janë dorëzuar nga të njëjtat. AK me rastin e ri-vlerësimit të dytë ka eliminuar GOE BERISHA COM SH.P.K. & JOOS KRASNIQI - BAZE SH.P.K. pasi nuk posedon licencë valide nga KPMM mirëpo i njejti edhe pse sipas pretendimit nr. 1 dhe 2 nuk paraqet palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit gjithashtu nuk përmbush edhe kriteret tjera të vendosura në FTD të cilat do i paraqesim në pretendimet në vijim.”

Pretendimi i shtatë (VII) ankuesi pretendon: “GOE BERISHA COM SH.P.K. & JOOS KRASNIQI - BAZE SH.P.K. me rastin e krijimit të grupit të operatorëve ekonomik nuk ka dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; Andaj AK duke vepruar në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së dhe nenit 26 të RRPP-së e ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një GOE i cili me rastin e ofertimit nuk ka dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit.” Pra, AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, nenin 26

të RRPP-së si dhe dispozitës nr. 10 të UPP-së. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi thekson ky GOE është eliminuar nga ana e AK-së prandaj nuk qëndrojnë dhe është e pakuptimtë përsëritja e këtyre pretendimeve. Ne prapë konfirmojmë se jemi pajtuar me vendimin e AK-së sa i përket eliminimit të këtij GOE mirëpo kemi paraqitur edhe pretendime të tjera për mungesë në dokumentacion të këtij GOE mirëpo pasi i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK-së atëherë mund të thuhet se ky GOE nuk është “palë me interes” që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së.”

Pretendimi i tetë (VIII) ankuesi pretendon: "GOE BERISHA COM SH.P.K. & JOOS KRASNIQI - BAZE SH.P.K. nuk plotëson kërkesën e përcaktuar tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dëshmia e kërkuar: Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim. Pasi ky GOE ka ofruar një Kamionët e tipit Mercedes Benz Tipi 316 CDI e cila edhe në bazë të fotografive shihet se nuk plotëson këtë kriter pasi është Kamionet dhe jo Kamion si dhe nuk posedon kran. Po ashtu ky GOE ka ofruar edhe një tjetër Kamionët me kran në marrëveshje (Kontratë mbi qiranë) me kompaninë Bashkim Rexhaj B.I. mirëpo e njëjta nuk është Kamion si dhe nuk ka afat valid të regjistrimit ashtu siç është e specifikuar në kërkesë. Pra, AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 69 të LPP-së. AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi thekson ky GOE është eliminuar nga ana e AK-së prandaj nuk qëndrojnë dhe është e pakuptimtë përsëritja e këtyre pretendimeve. Ne prapë konfirmojmë se jemi pajtuar me vendimin e AK-së sa i përket eliminimit të këtij GOE mirëpo kemi paraqitur edhe pretendime të tjera për mungesë në dokumentacion të këtij GOE mirëpo pasi i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK-së atëherë mund të thuhet se ky GOE nuk është “palë me interes” që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së. AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. PROPOZIM Andaj duke konsideruar se AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore, ku si pasojë e Shkeljeve të rënda ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga GOE FORTESA SHPK & ALBAPROJECT SHPK & N.P. Auremont pasi jemi ofertuesi i vetëm si palë me interes që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në kuptim të paragrafit 1.26 të nenit 4 të LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “FORTESA SH.P.K.”- Prizren konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1 paragraf 1, 2, 4, 7, 10, 11, 24 paragraf 2, 3, 52 paragraf 7, 55 paragraf 3, 56 paragraf 1.1, 1.2, 59 paragraf 1, 2, 4, 60 paragraf 1.1, 61 paragraf 2,4,5, 65 paragraf 1, 69, 71 paragraf 2 të LPP-së, si dhe nenin 7, 25, 26.1, 27.1, 30.4, 39.3, 40.1, 41.8 41.9 41.10, 97.c dhe 97.f të RRPP-së dispozita nr.10 e UPP-së për prokurim publik. Duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit

si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "FORTESA SH.P.K."- Prizren eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0856 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti sqaron: OE ankues me datë 24.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 26.10.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1. OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim të nenit 30 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 pasi që nuk ka kërkuar në afat ligjor vazhdimin e validitetit të ofertave. Rrethanat e çështjes: AK me datë 31.05.2023 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, Hapja e ofertave është bërë me datë 03.07.2023 Në dosjen e tenderit, në Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), përkatësisht tek Periudha vlefshmërisë së tenderit, neni 21.1, është përcaktuar: periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 60 ditë, Sipas dokumenteve në platformë, GOE FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K.; N.P. Auremont: me datë 31.08.2023 ka ngarkuar dokumentin "Konfirmim për zgjatje të vlefshmërisë së ofertës", në të cilin shënohet: "Deri në momentin e dorëzimit të këtij konfirmimi nuk kemi pranuar asnjë kërkesë nga AK për zgjatje të vlefshmërisë dhe sigurimit të ofertës edhe pse periudha e vlefshmërisë së tenderit ka qenë 60 ditë nga data e dorëzimit të tenderëve (03.07.2023), AK është dashur të veproj sipas Neni 30.4 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik. Andaj pasi procedurat për vlerësimin e ofertave të këtij aktiviteti të prokurimit janë zgjatur ne konfirmojmë se zgjasim vlefshmërinë e ofertës edhe për 60 ditë të tjera nga data e skadimit si dhe jemi të gatshëm ta vazhdojmë edhe për një periudhë më shumë nëse kërkohet nga AK. Ndërsa sa i përket sigurimit të ofertës i cili ka validitet deri me 01.10.2023, konfirmojmë poashtu se jemi të gatshëm ta vazhdojmë deri në periudhën e kërkuar nga AK."

AK me datë 04.09.2023 ka publikuar dokumentin -Kërkesë për zgjatje të validitetit të ofertës drejtuar OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet, ku shënohet: "Të nderuar, Pasi që projekti "Rregullimi i rrugëve fushore në zona rurale" me numër të prokurimit 632-23-5381-5-2-1 nuk është finalizuar, në mënyrë që të vazhdohen procedurat e prokurimit kërkoj nga ana Juaj duke u bazuar në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Neni 31 Validiteti i Tenderit paragrafi 4 që të zgjatni validitetin e ofertave deri në fund të aktivitetit.

Konfirmimin se pajtoheni për vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesës se AK duhet të dërgohet përmes Platformës elektronike të e-prokurimit respektivisht Dërgimi i dokumentit për Autoritetin Kontraktues më së largu deri me 06.09.2023. Nëse zgjatja e validitetit nuk konfirmohet brenda afatit kohor të lartë shënuar, oferta juaj do të refuzohet si e papërgjegjshme."

Në përgjigje të kërkesës së AK-së, me datë 04.09.2023 kanë dorëzuar konfirmimin për vazhdimin e validitetit të ofertës: GOE EuroVia SH.P.K.; ISEFERI SH.P.K.; GOE Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, GOE Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I.; GOE NIVA Construction SH.P.K.; VB. TOFAJ dhe GOE FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K.; N.P. Auremont (ku i njëjti e rikonfirmon vazhdimin e dërguar me datë 31.08.2023). Ndërsa me datë 05.09.2023 konfirmimin e kanë ngarkuar GOE BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K dhe GOE STONE GROUP SH.P.K.; BASHKIMI METI SH.P.K.

Neni 30.4 i RrPP përcakton "Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)"

Në lidhje me validitetin e ofertave KRPP me datë 22.11.2022 ka dhënë interpretimin si vijon: [...] Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së

skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)” “30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre”. Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohej zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Përgjigjja e Ekspertit në pretendimin ankimor 1 “Eksperti fillimisht sqaron se duke marrë parasysh që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte me 03.07.2023, në të cilën ditë edhe është bërë hapja e ofertave, afati i vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar nga AK prej 60 ditësh përfshinë periudhën kohore 03.07.2023 deri me 31.08.2023 (përfshirë ditën e dorëzimit të ofertave). Rrjedhimisht, kërkesa e AK-së e bërë me datë 04.09.2023 është në kundërshtim me nenin 30.4 të RrPP ku thuhet [...] kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Pra, AK është dashur që në pajtim me nenin e sipërpërmendur që para datës 31.08.2023 të kërkojë nga OE-të vazhdimin e vlefshmërisë së ofertave. Interpretimi i KRPP-së përcakton se është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, si dhe në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.”

Pretendimi ankimor 2 “OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim të nenit 30.4 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 pasi që nuk ka kërkuar në afat ligjor vazhdimin e sigurimit të ofertave. Rrethanat e çështjes. Në dosjen e tenderit, në Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), përkatësisht tek Siguria e tenderit, neni 13.2, është përcaktuar: Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90. Sipas dokumenteve në platformë, GOE FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K.; N.P. Auremont: me datë 29.09.2023 ka ngarkuar dokumentin “Sigurim Tenderi 9000 29.09.2023” me vlefshmëri nga data 01.10.2023 deri me datë 30.12.2023.

AK me datë 02.10.2023 ka publikuar dokumentin - Kërkesë për zgjatje të Sigurimit të tenderit për, ku shënohet: “Të nderuar, Pasi që projekti “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit 632-23-15381-521 nuk është finalizuar në tërësi, në mënyrë që të vazhdohen procedurat e prokurimit kërkoj nga ana juaj duke u bazuar në Ligjin për Prokurim Publik Neni 57 si dhe Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Neni 29 që të zgjatni Sigurimin e tenderit për një periudhë prej 90 ditë (Sigurimi duhet të bëhet pas skadimit të sigurimit të kaluar). Sigurimin kanë të drejtë ta bëjnë vetëm ata Operatorë Ekonomik të cilët e kanë bërë vazhdimin e validitetit të ofertës. Konfirmimin se

pajtoheni për vazhdimin e sigurimit të tenderit sipas kërkesës se AK duhet të dërgohet përmes Platformës elektronike të Prokurimit Elektronik respektivisht Dërgimi i dokumentit për Autoritetin Kontraktues më së largu deri me datë 04.10.2023 (në rast se përfundimisht do të ketë OE të suksesshëm, AK do të kërkojë që të ofrohet forma origjinale e Sigurimit të tenderit). Nëse zgjatja e sigurimit të tenderit nuk konfirmohet brenda afatit kohor të lartë shënuar, oferta juaj do të refuzohet si e papërgjegjshme”

Në përgjigje të kërkesës së AK-së, me datë 01.10.2023 kanë dorëzuar sigurimin e tenderit GOE STONE GROUP SH.P.K.; BASHKIMI METI SH.P.K.; GOE Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Ndërsa me datë 03.10.2023 vazhdimin e sigurimit e kanë bërë GOE EuroVia SH.P.K.; ISEFERI SH.P.K.; GOE BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K. Me datë 04.10.2023 vazhdimin e sigurimit e ka dorëzuar GOE NIVA Construction SH.P.K.; VB. TOFAJ. Ndërsa GOE Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I. nuk ka bërë vazhdimin e sigurimit të tenderit.

Përgjigjja e Ekspertit në pretendimin ankimor 2 “Eksperti sqaron se AK edhe në rastin e sigurimit të tenderit ka bërë kërkesën për vazhdimin e sigurisë së tenderit pasi ka skaduar afati 90 ditor i sigurimit të tenderëve i përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit. Sikurse është sqaruar mesipër në interpretimin e KRPP-së, AK nuk mund të kërkojë nga ofertuesit që në mënyrë retroaktive të bëhet zgjatja e sigurisë së tenderit. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.”

Pretendimi ankimor 3 “OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim të nenit 10.3 të LPP-së pasi i ka siguruar qasje GOE EuroVia SH.P.K. & ISEFERI SH.P.K. në dokumentet e ofertës të OE ankues të cilat janë klasifikuar si sekret afarist sipas nenit 11.3 të LPP-së. Rrethanat e çështjes:,OE ankues së bashku me tender ka dorëzuar Deklaratën për sekret afarist e cila është e nënshkruar dhe vulosur. Në deklaratë thuhet: Informatat ne lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare te nenit 68 dhe aftësia teknike ose profesionale te nenit 69 te Ligjit për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës. Ndërsa si arsyetim për mbajtjen si sekret afarist të këtyre informatave OE ka deklaruar: duke pasur parasysh se informatat sekrete afariste te cilat i kemi potencuar me larte (lexo: informatat ne lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare te nenit 68 dhe aftësia teknike ose profesionale te nenit 69 te ligjit për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës.) nuk janë prone publike dhe nuk janë informata te cilat janë te nevojshme te cilat do te mund te na shkaktonin dëmtime materiale te interesave legjitime komerciale qëllimisht apo ne mënyrë te pavetëdijshme nga operatorët e tjerë ekonomik, ne kërkojmë përmes kësaj kërkesë te konfidencialitetit qe informatat e tilla te jene informata sekrete afariste për operatorët e tjerë ekonomik, ashtu siç: është edhe ligjërish e mbrojtur me nenin 11 te Ligjit për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës dhe nenit 7 te RRUOP-se.

GOE EuroVia SH.P.K. & ISEFERI SH.P.K në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur në AK me datë 14.08.2023në lidhje me tenderin e dorëzuar nga GOE FORTESA SH.P.K.; ALBAPROJECT SH.P.K.; N.P. Auremont, ka paraqitur pretendimin: “FORTESA SH.P.K ALBAPROJECT te cilët edhe këta janë te pa përgjegjshëm dhe nuk kane licencë valide për gurrthyes pasi qe kërkesë e AK-se ne NJK dhe OT është qe : “Operatori Ekonomik duhet te ketë Gurëthyes dhe separacion të licencuar ose marrëveshje për furnizim Kopjet e licencave te vlefshme te lëshuar nga Agjencinë për Miniera dhe Minerale. Vërejtje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e Operatorit Ekonomik. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.Ndërsa GOE FORTESA SH.P .K.; ALBAPROJECT ka prezantuar vetëm licencën per sortues (seperacion) te datës 19.03 .2019 me vlefshmëri deri me 07/02/2024 e jo edhe Licencën për gurrthyes (vend shfrytëzim).”

Në lidhje me informatat sekrete afariste neni 11 i LPP-së, paragrafi 3 përcakton: “Autoriteti kontraktues mund t’i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kriterë: 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji; 3.2 që operator i përkatës ekonomik t’i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t’i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe 3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një

deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrihen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.”

Përgjigjja e Ekspertit në Pretendimin ankimor 3 “Eksperti fillimisht thekson se dokumenti (licenca) të cilit i referohet OE ankues si informacion që është zbuluar nga AK nuk mund të konsiderohet si sekret afarist duke qenë që është dokument i lëshuar nga një institucion publik në Kosovë, dhe konform nenit 11, paragrafi 3, pika (i) në deklaratën ku OE kërkon që informacionet të trajtohet si sekret afarist, OE duhet të sigurojë se një element i informacionit nuk është pronë publike. Për më tepër OE ankues nuk ka dëshmuar se dokumenti i është dhënë në dispozicion një OE tjetër nga AK. Informatat në lidhje me licencën janë publike dhe të qasshme në internet në ueb faqën e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në linkun në vijim: https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FORTESA SH.P.K.”- Prizren Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 856/23, ndërsa me datë 04/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0856 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet. Ndërsa OE Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale,

rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik, Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si pjesërisht të bazuara.

Po ashtu Paneli shqyrtues konstaton se raporti i ekspertit ka vlerësuar se kërkesa e Autoriteti kontraktues drejtuar Operatorëve ekonomik për sigurimin e tenderit është bere ne kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik Neni 57, paragrafi 4.3 që përcakton se “afati kohor për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve”, po ashtu si dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, në faqen 41 lidhur me nenin 57 të LPP, kur mungon sigurimi refuzohet tenderi. Autoriteti kontraktues edhe në rastin e sigurimit të tenderit ka bërë kërkesën për vazhdimin e sigurisë së tenderit pasi ka skaduar afati 90 ditor i sigurimit të tenderëve i përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit. Sikurse është sqaruar mesipër në interpretimin e KRPP-së, AK nuk mund të kërkojë nga ofertuesit që në mënyrë retroaktive të bëhet zgjatja e sigurisë së tenderit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa është si pjesërisht e bazuar e OE “FORTESA” SH.P.K kundër “Njoftimin mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "632-23-5381-5-2-1",. Ky aktivitet i prokurimit ka pasur shkelje procedurale të ligjit të cilat janë të konstatuara edhe në raportin e ekspertit shqyrtues dhe të vet Panelit shqyrtues, andaj përfundimisht Paneli vendos që të Anullohet vendimi për “Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “ i datës 11.08.2023 dhe lënda kthehet në Ritenderim dhe AK ti eliminoj shkeljet ligjore të konstatuara të panelit.

Paneli shqyrtues po ashtu konstaton se kjo shkelje procedurale e ligjit nga ana e Autoritetit kontraktues, nuk ka pasur ndonjë efekt që ka dëmtuar operatorin ekonomik ankues, por as ndaj të gjithë operatorëve ekonomik ofertues, pa dallim, andaj dhe kërkesa e AK drejtuar OE me vonese prej 4 ditëve për vazhdim të validitetit të ofertës, nuk ka pasur ndonjë favorizim apo ndikim në rezultatet e vlerësimit të ofertave, përkatësisht të përzgjedhjes së operatorit ekonomik të rekomanduar i përgjegjshëm administrativisht dhe me çmim me të ulët. Paneli shqyrtues konstaton se kjo shkelje procedurale nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka dëmtuar vete Autoritetin kontraktues, i cili nuk ka mund ta përfundojnë këtë aktivitet të prokurimit me kohë, për shkak të ankese se paraqitur nga OE ankues, andaj zyrtari prokurimit duhet të jete i vëmendshëm dhe të mos përsërit shkeljet ligjore të konstatuara, në të kundërtën do të mund të iniciohen procedurat ligjore për marrje të licencës në autoritetin përkatës.

Paneli Shqyrtues konform nenit 1 dhe 6 të LPP dhe nisur gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit dhe konform nenit 24, paragrafi 2 i LPP janë përgjegjës së aktiviteti i prokurimit të zhvillohet konform dispozitave ligjore në fuqi.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës së Operatorit ekonomik, vendos ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - FORTESA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: